



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva.

**RAPORT PUNE NGA SEKTORI I BUJQËSISË DHE ZHVILLIM RURAL PËR
MUAJIN MARS 2023**

- ❖ Shqyrtimi i kërkesave në intranet
- ❖ Pjesëmarrje zyrtare në komisione dhe vlerësime të ndryshme
- ❖ Regjistrimi i fermerëve të rinjë në regjistrin e fermës
- ❖ Paisja me NIF sipas kërkesave të fermerëve
- ❖ Informata dhe këshilla të vazhdueshme për fermerë sipas kërkesave të tyre
- ❖ Ka vazhduar pranimi i aplikacioneve nga fermerët në Programin e Pagesave Direkte për vitin 2023
- ❖ Lëshuar dy (2) Vendime për ndërrim destinimi të tokës(tokë bujqësore në tokë ndërtimore) si dhe dorëzuar raportin financiar në DBF
- ❖ Me zyrtarët nga IADK-ja është punuar në teren-janë zhvilluar vizita fermerëve aplikues në projektin „Përmirësimi i punësimit dhe mundësive për gjenerim të të ardhurave në zonat rurale (përkrahje me serra ,llaktofriz dhe pajisje për bletari)
- ❖ Me 01.03.2023 është publikuar ftesa për aplikim në projektin „Përkrahje me fidane të mjedrave” për 40 përfitues
- ❖ Me 14.03.2023 është publikuar ftesa për aplikim në projektin „Përkrahje me feferona” për 40 përfitues
- ❖ Me 20.03.2023 është mbajtur Sesion informues nga përfaqësuesit e Qatar Charity lidhur me Kultivimin e perimeve në ambiente të mbyllura (serra) për përfituesit e serrave prej 96 m²

- ❖ Më 24.03.2023 është publikuar ftesa publike në projektin „Serra bujqësore 300 m²” për 45 përfitues
- ❖ Publikimi i listës fituese në projektin „Përkrahje me motokultivator” së bashku me organizatën Qatar Charity dhe shpërndarja e motokultivatorëve me frezë dhe kosë me dt.30.03.2023

AKTIVITET E ZHVILLUARA NË SEKTORIN E PYLLTARISË GJATË MUAJIT MARS 2023

- ❖ Realizimi i konfiskimeve të masës drusore në sasi prej 11.78 m³ dru zjarri.
- ❖ Pranimi i gjithsej 14 fletëparaqitjeve kundërvajtëse me vëllim prej 20.31 m³ dhe 2 fletëparaqitjeve penale me vëllim 13.13 m³ , të cilat janë përcjellur në Gjykatën Kundërvajtëse dhe në Prokurori.
- ❖ Përfundimi i revizionit pyjor në REP Murgullë si dhe në REP Turuqicë me qëllim të konstatimit dhe regjistrimit të gjendjes ekzistuese sa i përket dëmeve pyjore.
- ❖ Pranimi i gjithsej 7 aktvendimeve, prej të cilave 6 janë kundërvajtëse me vëllim prej 7.391 m³, ndërsa 1 është penale me vëllim prej 2.26m³ .
- ❖ Pranimi i gjithsej 181 kërkesave për leje për prerje në pyje private të cilat janë dërguar në DKR të APK-së për shqyrtim, ndërsa janë paisur 2 pronarë të pyjeve private me leje për prerje pylli me ç’rast të hyrat nga shërbimet në pyje private janë 45.3euro.
- ❖ Realizimi i kontratës për shitjen e masës drusore-dru zjarri që ndodhet e deponuar në depon e fshatit Peran.
- ❖ Raportimi i rregulltë në baza mujore në DKR të APK-së lidhur me gjendjen e pylltarisë në Komunën tonë.
- ❖ Pjesëmarrje në komisione dhe vlerësime të ndryshme
- ❖ Realizimi i kontrollave të rregullta nga zyrtarët e pylltarisë në Rajone Ekonomike Pyjore.

Nr.protokoli 02-409/04-0025613/23

07.04.2023

Podujevë



Drejtori

Fatmir Rudari